

BIBLIOTEKA

25H-1

K 78

LAME KODRA

V J E R S H A

SHTEPIA BOTUESE EQEREM ÇABEJ

TIRANE 1994

2SH-1

778

LAME KODRA

V J E R S H A

BIBLIOTEKA E

BASË SË BUKASTËR

NO. V - 53511

TIRANE 1994



LAME KODRA
(SEJFULLA MALESHOVA)

«Problemi i kulturës është lidhur ngushtë me të gjitha problemet e mbëdha të vëndit t'onë, me të gjitha aspiratat e popullit shqipëtar, me luftën dhe përpjekjet e tij per liri e përparim. Këtëj del edhe roli i kulturës në Shqipërinë e sotme. Te gjitha forcat kulturele — teknike, shkencat, arti, literatura — duhet të vihen në shërbim të atdheut për të realizuar detyrat e mbëdha historike që ka përpara populli shqipëtar.»¹⁾

LAME KODRA

1) Nxjerrë nga broshura: *Roli i kulturës në Shqipërine e sotme*, botuar në vitin 1945.

PARATHENIE

Emri i Lame Kodrës tashmë është i rrethuar me një lloj enigme apo mjegullnaje, të cilën është tepër e vështirë ta shpërndash. Shumë prej bashkëkohësve që e njihnin nga afër, tashmë prehen në varreza. Ata që janë gjallë nuk mund të të ndihmojnë në shumicën e rasteve, sepse janë krejtësisht të papërgatitur dhe nuk e mendonin se do të vinte një ditë kur dëshmia e tyre do të duhej jo thjesht për të ndriçuar një personalitet të kulturës sonë, por edhe një periudhë të vështirë të kulturës dhe historisë shqiptare.

Nga ana tjetër, gjykimi për Lame Kodrën si poet e përkthyes, politikan e organizues i kulturës në vitet e pasLuftës Nacionalçlirimtare është tepër i vështirë edhe nga ato që ai ka lënë shtypur nëpër libra. Sidoqoftë, një gjë është e qartë: ky personalitet i kulturës dhe letërsisë sonë meriton të studjohet dhe t'i jepet vendi që i takon.

Duke gjykuar nga dy broshura «Artikuj dhe ligjërata» (1939 - 1945) dhe «Roli i kulturës në Shqipërinë e sotme», botuar të dyja më 1945, diçka mund të thuhet për të si publicist dhe si organizator i kulturës, për konceptet e tij në këtë fushë. Por këto fusha le t'i mbeten së ardhmes dhe le të themi dy fjalë për poezinë e tij, që tani po sheh dritën e botimit qysh nga viti 1945 kur u botua libri i tij i titulluar «Vjersha». Nuk e dimë a ka më krijime të tjera Lame

Kodra, a shkroi vallë dhe a përktheu gjatë periudhes së gjatë të internimit. Zbulimi dhe dorëzimi i këtyre dorëshkrimeve në rast se ekzistojnë, do ta bënte më të plotë portretin e këtij krijuesi.

Lame Kodra shkroi pak. Me sa duket kjo ndodhi jo vetëm prej natyrës së tij krijuese që e kushtëzonte patjetër këtë gjë, por, ndoshta, edhe se i pagoi haraçin politikës. Duke u marrë vazhdimisht me politikë, me jetën aktive shoqërore qysh djalë i ri e deri sa u godit nga diktatura komuniste, ai krijoi mungesa si poet dhe sidomos si përkthyes ku shkëlqeu me një talent të rrallë dhe përbën një fenomen krejt të veçantë në historinë tonë të përkthimit ndonëse edhe këtu ka një numër të vogël faqesh. Natyrisht, të vjen keq kur shikon shkëlqimin e talentit të tij si përkthyes dhe krahas me të ato pak vjersha apo proza poetike që na la të përkthyer. Por kjo s'na pengon të themi se ai ishte një përkthyes që i kalonte kufijtë e zakonshëm, një mjeshtër dhe një njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe. Si në vjershat origjinale ashtu edhe në Shqipërimet gjuha shqipe e Lame Kodrës nuk tregon, por këndon, nuk shkruhet, por derdhet nga qiej hyjnorë e misteriozë, nuk kuptohet, por ndjehet, jetohet, preket. Thesari i gjuhës shqipe është për të një piano që kumbon në mënyrë harmotike, melodioze, të papërsëritshme.

Si poet Lame Kodra përpigjet të realizojë ndërlihdjen midis poezisë së Rilindjes dhe vazhdimit të poezisë shqipe që do të krijohet pas Luftës së Dytë Botërore. Por, duhet thënë, ai përshumëçka mbetet më tepër i radhitur në poezinë e Rilindjes, ndonëse e pasuron atë me një frymëmarrje dhe kontrast krejt të ri. Me sa duket, ai nuk i shpëtoi dot deri në fund

ndikimit të poezisë noliane, poezi që duket menjëherë e ka patur shumë për zemër.

Po ta shikonim të shkëputur dhe ta konsideronim për efekt studimi poezinë vetëm në rrafshin tematik, mund të thoshim se poezia e Lame Kodrës ka një tingëllim të veçantë për atë kohë, sidomos me thekset për Luftën e popullit tonë kundër pushtuesve fashistë. Pavarësisht nga kjo konstitucioni shpirtëror i Lame Kodrës si poet i përket më tepër poezisë noliane dhe, herë-herë, edhe asaj çajupjane. Me çajupin atë e lidh edhe diçka tjetër: mbështetja e fuqishme tek poezia popullore. Lame Kodra ndjehet që e do dhe e shfrytëzon me mjeshteri këngën e popullit, sidomos ndërtimin e këngës labe, thyerjet, larushine, thekset e saj të veçanta e shpesh herë befasuese, lirizmin pak të ashpër, por gjithsesi të ngrohtë e njerëzor.

Një gje është pak e çuditshme: nuk ka diskutim që Lame Kodra e njëjtte mirë letërsinë evropiane, ose, të paktën, një pjesë të mirë të saj. E megjithatë, ndikimi i kësaj poezie ndihet fare pak. Aq shumë është i zhytur poeti në krijimtarinë popullore shqiptare, sa nuk ka lenë vend për asnjë ndikim pozitiv tjetër. E, në rast se si poet ky është një fakt që nuk i bën ndonjë nder të veçantë, madje e dëmton, vlerat morale të Lame Kodrës marrin një shkëlqim e kuptim të veçantë, duke i gjykuar ngushtë me rrethanat e veçanta të jetës së tij. Ai u akuzua nga Enver Hoxha si liberal kozmopolit etj. etj. Çfarë paradoksi!

Lame Kodra nuk shkruan, po gdhend. Poezitë e tij të kujtojnë ato gdhendjet muratorike në gurin e ashpër, gurë të cilët zbukuroheshin në qoshet apo sipër portave të shtëpive shqiptare. Ai nuk vargëzon

duke renditur fjalë, por kërkon fjalë të tilla që të rëndojnë e të zënë vend si gurët në një mur mjeshtëror. Ai kërkon harmoninë dhe melodinë si element bazë të harmonisë, kërkon latimin dhe gdhendjen e mundishme si element bazë të arkitekturës poetike. Më tepër se tek zbulimet e befta poetike, forca e poezisë së Lame Kodrës qëndron tek gjetja dhe gdhendja e vargut dhe e fjalës, mënyrë kjo e pranuar si në poezinë evropiane edhe në atë shqiptare.

Midis vjershave të Lame Kodrës ka ndonjë syresh me bukuri të veçantë. Me të drejtë «Si e dua Shqipërinë», shkruar më 1939, u përhap aq shumë sa u bë një lloj hymni. Nuk është vetëm tingëllimi i saj ideor (hymn për Shqipërinë kur ajo është e pushtuar) që e bëri atë aq të dashur. Mbi të gjitha është fakti se në të gjen realizëm të plotë talenti poetik i autorit të saj. Fjala e thjeshtë por plot tingëllim, harmonia e patrazuar dhe e pashkelur asnjëherë. Çiltërsia e komunikimit, e bëjnë vjershën të të pëlqejë edhe sot, pas kaq vitesh. Duke e lexuar të vjen ta këndosh me meloditë tona të njohura popullore, të nxit të ngrihesh në valle, të ndjesh me të vërtetë diçka prej njeriu dhe shqiptonjë njëkohësisht. E këto t'i jep vetëm arti i vërtetë, i papërsëritshëm.

Përkthimet e Lame Kodrës janë një kapitull me shumë interes. Ndërsa si poet ai është një zë i veçantë, si përkthyes është një mjeshtër me peshë të madhe. Fjala shqipe në të peshon shumë rëndë. Kam krahasuar disa herë përkthimin e «Lajmëtarit të Furtunës» të Gorkit. Është me të vërtetë diçka unikale. Përkthimi është tepër i saktë nga ana kuptimore, ndërsa tingëllimi shqip është i çuditshëm, duket sikur Gorki nuk e ka shkruar rusisht, por shqip. Po kështu ndodh

edhe me «Internacionalen», e cila ma do mendja, në shqip gjen një nga përkthimet më dinjitoze se të gjithë gjuhët e tjera.

Padyshim, si përkthyes Lame Kodra është një nga talentet e mëdhenj shqiptarë. Mjeshtëria dhe talenti i tij ia vlen të studjohen, ndonëse numri i përkthimeve që na la është tepër i vogël. Këtij personaliteti, ka ardhur koha t'i jepet vendi që meriton në fushën e përkthimeve.

Në fund një pyetje: Lame Kodra apo Sejfulla Malëshova? Në letërsi njihet Lame Kodra, në politikë Sejfulla Malëshova. Ç'të jetë kjo? Askush s'mund t'i përgjigjet saktë. Do të desha të ishte dëshira për të mos ngatërruar politikën me artin... Uroj që të jetë kjo.

BARDHYL LONDO

P O E T I R E B E L ¹⁾

Pa dëgjoni, gra e burra,
Anëmbanë
Dolli urdhëri për mua
Në Tiranë.
Nëpër male, nëpër fusha,
Në luadhe
Po më ndjekin këmba-këmbës
Me koshalle.²⁾
Po s' kam frikë nga zagari
Me dyfek ;
Kudo shkoj e hidhem unë
Shtek më shtek.
Kudo vete e futem unë
Prak më prak :
Shqipërinë anëmbanë
Kam jatak.
Jam rebel e jam hajdut ³⁾
Edhe mburrem ;

1) Është shkruar më 1935. U botua më 1941 në gazetën «Liria» në Amerikë.

2) Xhandarët që ndjekin të arratisurit.

3) Jo kusar, po hajdut si Gjoleka, Tafil Buzi, Rapo He-kali, Shemo Hajduti, që kishin dalë maleve për të mprojtur të drejtat e fshatarëve.

Kundër beut edhe frontit
Un turrem,
I kam dalë për zot unë
Vegjëlisë,
Edhe luftë i kam shpallur
Skllavërisë.

. . .

Kush ngre pushkën kundër meje
Kështu vallë ?
Kush pas gjurmëve të mia
Vjen vërdallë ?
Qëndro pakë, dëgjo mua,
Or ushtar ;
Nuk je vallë bir fshatari,
Ti, fshatar ? ¹⁾
Qëndro pakë, dëgjo mua,
Or vëlla ;
Mbaje dorën, kurse plumbin
Për ata ;
Për ata që rrjepin, shtypin
Shqipërinë,
Për ata që na çkallmuan
Katandinë.

. . .

1) Si fshatarë që janë ushtarët nuk duhet të ndjekin
e të vrasin ata që lëftojnë për të drejtat e popullit, po të
bashkohen me ta në luftën për liri.

* * *

Edhe vjersha më ka hie
 Si hajdut,
 Pse dhe vjershat i mbush unë
 Plot barut.
 Këngë lufte, këngë zjarri
 Kam në gojë ;
 E kam unë kraharorin
 Si debojë¹⁾.
 Vjershë, o vjershë, shko si bombë
 Me tërbim ;
 Shko përhapu si flamur,
 Si kushtrim.
 Anëmbanë Shqipëria
 Le të mblidhet :
 Nër pallate tirania
 Le të dridhet.
 Ngreu Korçë, Korç' o lule,
 Korça-Zonjë,
 Me Devoll e me Opar,
 Me Kolonjë.
 Del, pa del, o lum' i Vlorës
 Me bajrak :
 Sikur del të marrësh nuse
 Me duvak.
 Shko në ballë si Gjoleka,
 Kurvelesh,

1) Trajtë popullore e tijës depo.

Hidhu ti, moj Çamëri,
Si rrebesh.
Sokëllin Baba Tomori
Si tërmet,
Dhe Shkumbini valë-valë
Pë buçet :
Ngreu, popull, shkunde zgjedhën
Si luan,
Në Berat e në Tiranë, e
N' Elbasan.
Dhe ti Mat e Lumë e Dibër
Si duhi,
Rokni armët e lëftoni
Për liri.
Gjëmo, Shkodër, moj mizore,
Shkodra-plakë ;
Dil me Malet, mbushe dheun
Zjarr e flakë.
Hajde, hajde, tunde vallen
Moj Kosovë,
Me Krasniqn' e Bajram Currit,
Me Tetovë.
Anëmbanë Shqipëria
Le të mblidhet ;
Nër pallate tirania
Le të dridhet.
Vjershë o vjershë, shko si bombë
Me tërbim ;
Shko përhapu si flamur,
Si kushtrim.

FURTUNES 1)

(Pas një poeti gjerman)

Më thërret, o moj furtunë,
Po burgosur gjëndem unë.
Edhe unë jam si ti :
Zjarrë e luftës kam në gji.
Po vjen dita dhe shpëtoj,
Thyej hekurat e shkoj,
Hidhem lark në hapësirë,
Të paanëshme, të lirë,
Edhe tutjë nëpër dete,
Në katunde e në qytete,
Nëpër fusha dhe bregore
N' tru e zëmra njerëzore
Me tërbim do turrem unë,
Si dhe ti, o moj furtunë.

1) Një revolucionar mbyllur në burk. Rreth e rrotull burgut shfryn e rrembyer furtuna, që duket sikur e thërret të dalë jashtë të hidhet në hapësirën e lirë, të ndezë popullin e të përfshijë sundonjës e tiranë.

Vjersha është shkruar më 1927 dhe botuar më 1928 në gazetën «Liria Kombëtare».

SI E DUA SHQIPËRINË ¹⁾

S' kam çiflik e s' kam pallate,
S' kam dyqan me katër pate;
Po e dua Shqipërinë
Për një stan në Trebeshinë,
Për një shkarpë e për një gur,
Për një garth e për një mur,
Për kasollen mi Selishte,
Për dy ara në Zallishte,
Për një lopë e një gomar,
Për një Balo, një manar.
Unë e dua Shqipërinë
Si bari dhe si fshatar.

Unë e dua Shqipërinë
Për tërfilin mi lëndinë,
Për një vajzë gjeraqinë,
Dhe për ujët që buron
Nga një shkëmb e gurgullon

1) Është shkruar më 1939; është botuar më 1941 në gazetën «Liria» në Amerikë.

Nëpër lisat gjethe-shumë,
Edhe zbret përposh në lumë.
Unë e dua Shqipërinë
Për një lule trëndelinë,
Për një zok që fluturon,
Për bilbilin që këndon
Në ato ferra e në ato hie
Këngë malli e dashurie,
Këngë shpirti të helmuar :
Unë e dua Shqipërinë
Si poet i dhëmshëruar.

Unë e dua Shqipërinë
Që nga Korça e në Vraninë,
Ku del bujku që me natë
Me parmëndë edhe me shatë,
Mbjell e korr me djell, me hënë
Dhe s' ka bukë për të ngrënë;
Ku nallbani e samarxhiu
Mjeshtri, kallfa e kallajxhiu,
Krrusen ditë e krrusen natë,
Që të hanë bukë thatë ;
Ku hamalli nëpër skela
Ngarkon hekur e varela,
Këmbë-zbathur, bythë-çjerë :
Punon vetëm për të tjerë.

Unë e dua Shqipërinë
Që nga Shkupi e në Janinë,
Ku një popull derë-zi
Heq e vuan robëri,
Po ka shpirtin luftëtar :

Unë e dua Shqipërinë
Si një revolucionar.

KËNGA E PLAKUT ¹⁾

Këmbë-kryq përmi Selishte, ²⁾
Po nis këngën pleqërishte,
Ndes çibukun e kujtoj
Djalërinë që më shkoi.

Kujtoj bejkat me këmborë,
Kujtoj vajzat me kurorë,
Kujtoj dasmë dhe dolli:
Oh! e lumja djalëri.

Kujtoj fushat e Moresë, ³⁾
Kujtoj Urën e Qabesë, ⁴⁾
Kur lëftoja si luan
Me pisqollë e jatagan.

1) Është shkruar në Maj 1939; botuar më 1941 në gazetën «Liria».

2) Ara rreth e rrotull shtëpisë.

3) Moreja është Greqia, ku shqipëtarët lëftonin një kohë për hesap të Turqisë.

4) Ura e Qabesë ndodhet në Arabi; përmendet në disa këngë popullore.

O! sa trima kanë mbetur,
O! sa eshtra janë tretur,
Atje lark, atje përposh
Për një thelë e për një grosh.

Dhe tani që jam këtu
Mbeta vetëm si kërcu.
Haj! moj shtriga pleqëri
Me lëngatë e me uri.

Dhe Havaja ¹⁾ ime e shkretë
Po pushon e flë për jetë,
Atje poshtë me një brinjë,
E mbuluar me dëllinjë.

Shkova unë lark e lark
Hodha sytë rreth e qark,
Po kudo në Shqipëri
Hekin keq e hekin zi.

Po si vallë njerëzia
Nuk u-loth nga robëria?
Po si vallë s' ka një djalë
Me flamur që të na dalë?

1) E shoqia.

Bini armët këtu mua,
Do lëftoj si një Drangua,
Sa të çduken anembanë
Sundimtarë dhe tiranë.

Ngrihem unë mi Selishte
Dhe nis vallen djemurishte ;
Tunt shaminë edhe këndoј :
Për liri do të lëftoj.

KLITHMA E DRAGOBISË 1).

Natë e errët mi Shkumbin,
Mi Bujanë,
Dhe mi Vjosën valë-turbull:
Anëmbanë.

Dergjet bota punëtore,
Botë e ngratë,
Shpirt e zemër pikëlluar,
Zorrë-thatë.

Jashtë akull, shkon si gjarpër
Vetëtima,
Edhe fryn në grykë' e male
Suferinë.

Një kasolle me kandil
Dikë pret :

Shkruar në Janar 1941, botuar në gazetën «Liria» më 1942.

1) Në malet e Krasniqit, në Dragobi, në Janar 1925 u vra nga mercenarët e Zogut patrioti i math, kryetari i fshatarëve të Kosovës—Bajram Curri.

Burrin malit ose djalin
Lark në det.

O! sa nëna, o! sa motra
Shqipëtare
Po përgjojnë qyqet sonte
Në dritare ¹⁾

* * *

Natë e keqe mi Shkumbin,
Mi Bujanë
Dhe mi Vjosën valë-turbull:
Anembanë.

Jashtë akull e furtunë,
Bora det:
O! sa dimër i tërbuar
Ky, sivjet.

Jashtë lufta ²⁾ mortje-madhe
Kudo zjen:
Sipër maleve të larta,
Në derven.

Bumbullojnë kudo topi,
Batareja:

1) Presin burrat e djemtë e tyre, që i ka zënë nata dhe furtuna, rinë e mejtojnë për njerzit e tyre në luftë.

2) Lufta italo-greke më 1940-41.

Buzë Vjosës, nga Tomori,
Nga Dumreja. 1)

Edhe qiellit shkab e hekurt, 2)
Nëpër re
Shfryn me bomba, lëshon vdekje
Përmi dhe.

Kullon malit, kullon fushës
Gjaku det,
O! sa dimër i tmerruar
Ky, sivjet

* * *

Natë e thellë mi Shkumbin
Mi Bujanë,
Dhe mi Vjosën valë-turbull:
Anëmbanë.

Si të flerë mëndja ime
Kësaj nate:
Ajo gjuan nëpër shtigje,
Monopate,

Po çan hiet mal më mal,
Nëpër dete,

1) Anë Vjosës, në Skrapar, Tomoricë e në Dumreja.
bënë luftat më të rrepta.

2) Aeroplanët.

Fluturën përmi katunde,
Mi qytete.

Si të heshtë zëmra ime
Sonde vallë :
Ajo ndizet e tërbohet,
Vjen vërdallë.

Qan si qajnë gratë e gjora
Shqipëtare,
Shfryn, buçet si djemuria
Luftëtare.

Po, pa dale . . . se kush ndjeu
Zëmrën t' ime,
Se kush shkon si zjarr i shpejtë
N' agullime.

Mos ka dalë sonde natën
Nonjë trim
Edhe sillet nëpër male
Me kushtrim ?

Sonde natën me furtunë
Mos ka dalë,
Dhe ngre popullin më këmbë
Nonjë djalë ?

Jo, mor jo, të gjallë sonde
S' po dëgjohen ;
Dhe prandaj në varr të thellë
Zëmërohen,

Edhe ngrihen zëmër-gur,
Duar-hekur
Gjithë ata që për lirinë
Kanë vdekur.

Ja, nga brigjet e Tiranës ¹⁾
Del Naimi :
Dydh i verdhë, sy-shkëlqyer
Nga mejtimi. ²⁾

Pa shiko Orman Çifliku ³⁾
Si lëvis
Më çdo shtek e më çdo gropë,
Më çdo lis.

Gjashtë djem posi shqiponja
Fluturojnë,

1) Eshtrat e Naim Frashërit ndodhen në kodrat mi teqen e bektashinje në Tiranë.

2) Fëtyra e verdhë, e ndritur, sytë e tij plot flakë pasqyrojnë zjarrin e brëndshëm, pasjonin e math të këti poeti e apostulli të lirisë kombëtare,

3) Në Orman Çiflik u vranë nga xhondarët e Turqisë më 1911, gjashtë djem të rinj, që kishin dalë maleve për lirinë e Shqipërisë.

Dhe te shpella e Dragobisë
Po qëndrojnë.

Vetë shpella si tërmeti
Oshëtin:
Plaku i malevet ¹⁾ ka dalë,
Sokëllin.

Selam Musa Salaria ²⁾
Del nga Vlora,
Me një shark, qylaf të bardhë
Si dëbora.

Prite, prite, vjen Avniu, ³⁾
Dragobi:
Rroi e vdiq zëmër-luani
Për liri.

Ja, po del Riza Cerova ⁴⁾
Që nga varri;

1) Bajram Curri, që tërë jetën e shkoi në male duke lëftuar për lirin e popullit, dhe kurrë nuk iu shtrua zgjedhës së tiranisë.

2) Një nga herojtë e luftës së Vlorës më 1920.

3) Themelonjës i shoqërisë «Bashkimi». Ekzekutoi më 1920 trathëtorin Esad Toptani. U vra nga larot e koalicionit të bejlerëve më 1924.

4) Patriot i cquar nga Skrapari. Kapiten në ushtrinë shqiptare gjër më 1925, I arratisur politik, pas «Triumfit të Legalitetit», d. m. th. të koalicionit të bejlerëve me Zogun në krye. U vra më 1935 në Mokër afër Shën Marinës nga xhandarët e Zogut.

Rreth e rrotull i shkëlqejnë
Yje zjarri, —

Yje zjarri dymbëdhjetë ¹⁾
Si kurorë.
O! çudi! po mbushen malet
Me dëshmorë.

Ja po vjen duke kënduar
Si rrufe,
Me flamur të kuq në dorë
Çet' e re. ²⁾

Shkon Aliu ³⁾ sy-drangua,

1) Njëmbëdhjetë xhandarët dhe Hekuran Margëlleci që u vrarë më 1935, pse kishin marrë pjesë në lëvizjen e Fierit.

2) Komunistët shqiptarë që kanë trashëguar traditat e patriotëve të vjetër në luftën për liri të Shqipërisë e të popullit shqiptar. Kur është shkruar këjo vjershë, më 1941, nuk kish nisur vargu i math i atyre, që në luftën e sotme ranë e po bien dëshmorë për lirinë e Shqipërisë. Një pjesë e madhe e këtyre kanë dalë nga radhët e komunistëve dhe Partia Komuniste Shqiptare, flamurtare në luftën e sotme për çlirimin nacional, po ndjek udhën që i treguan Ali Kelmendi Halim Xhejua e Asim Vokshi.

3) Ali Kelmendi nga Peja, Ushtar i Bajram Currit. Më 1925 u arratis në Europë. U kthye në Shqipëri më 1931. Një nga organizatorët e lëvizjes punëtore e komuniste në Shqipëri. Shumë herë internuar e burgosur.

Shkon Halimi, ¹
Shkon Thanasi ²⁾ Ten' i zjarrtë, ³⁾
Shkon Asimi. ⁴⁾

E të gjitha ato hie
Luftëtare
Mblidhen rrotull Dragobisë
Legjendare.

1) Halim Xhelua nga Tërinci i Vlorës. Djalosh 14 vjec
doli maleve, shok me 6 dëshmorët e Orman Çiflikut. Luftëtar
e gazetar i çuqar, partizan i një Shqipërie demokra-
tike popullore. Redaktor i gazetës «Politika» më 1923-24. Stig-
matizoi politikën reacionare të koalicionit feudal dhe intri-
gat e tij me të huajt. Me 1924. pas «Triumfit të Legalitetit»
doli jashtë, ku vazhdoi luftën si anëtar i organizatës «Çlirimi
Nacional» dhe redaktor i «Lirisë Kombëtare». Kish aderuar më
1925 në lëvizjen komuniste.

2) Thanasi Zikua nga Sofiku. Me 1937 u nis për në Spanjë
të luftonte kundër fashizmit për lirinë e popullit. Udhës muaj
me radhë u dërgj nëpër burgjet e Jugosllavisë e të Ruma-
nisë ku u sëmur e u bë verem. Anëtar i Komitetit të Qënd-
res së «Federatës së Shqiptarëve në Francë», që hodhi për herë
të parë idenë e organizimit të një «fronti të përbashkët na-
cional» kundër zgjedhës fashiste në Shqipëri. Kjo organizatë
me organin e saj «Sazani» dënoi me trathëti kapitullimin e
krerëve të «Bashkimit Kombëtar» si Ali Kelcyra, Qazim Kocullii
Kol Tromara, Rexhep Mitrovica etj. që u kthyen në Shqipëri,
dhe bashkëpunuan me okupatorin fashist. Me 1939 aderoi
në lëvizjen komuniste.

3) Teni Konomi, komunist, një nga krerët e lëvizjes pu-
nëtore në Korçë. Vdiq në Spanjë, ku kish vajtur të luftonte
kundër fashizmit.

4) Asim Vokshi, oficer në ushtërinë shqiptare, i çveshur
me 1935 si kundërshtar i regjimit Zogist. U vra në Spanjë ku
ish shquar për trimërinë e zotësinë e tij si kapiten i ushtërisë
republikane. Komunist.

Vetë shpella, gryk' e male
Bumbullojnë,
Kur dëshmorët token, puthen,
Kuvëndojnë.

Vetë shpella, gryk' e male
Po buçasin,
Kur dëshmorët gjithë bashkë
Po këlthasin :

Luftë luftës, luftë zgjedhës,
Shqipëri ;
Ngreu, popull, me flamurë
Për liri.

Klithm' e madhe po can natën
Si rrufeja ;
Po përhapet buzë Vjosës;
Nga Dumreja.

E dëgjon maj' e Tomorit,
E thërret ;
E dëgjon val' e Shkumbinit,
E buçet ;

E dëgjon shpirt' i poetit,
E këndon :

Këng' e tij, trumbetë lufte,
Po gjëmon.

• • •

Natë e errët mi Shkumbin,
Mi bujanë
Dhe mi Vjosën valë-turbull:
Anëmbanë.

P R A K U ¹⁾

Heshtj' e madhe rreth e rrotull edhe vetëm shkretëtirë
Del nga nata me mistere një pallat në errësirë.
Ngrihen muret si kështiuella mbushur gjak e mizori
Dhe një derë atje rri hapët. Përtej saj, në hon të zi,
Janë hiet edhe heshtja e një bote të panjohur.
Rri një djalë para prakut, rri më këmbë. Fryn e ftohur
Del nga brënda një erë e keqe që pështjell edhe fërkon
Atë djalë si me drithma. Lart po ngjiten nga ay hon
I atij praku të mistershëm me ngadale këto fjalë,
Që dëgjohen fare çkoqur, duke ordhur valë valë :

1) Subjekti i kësaj vjershe është marrë nga një proz' e shkurtër poetike e shkrimtarit rus Ivan Turgenjef, po është zhvilluar, ndryshuar dhe punuar që sa munt të quhet një vjershe fare origjinale.

Është shkruar me 1919, botuar për herë të parë me një variant tjetër, më 1921, në gazetën «Dielli» dhe për herë të dytë në gazetën «Bashkimi» më 1924.

Praku është udha-kryq, ku një djalë duhet të zgjedhë në mes të një jete me luftë e me mundime kushtuar lirisë, dhe një jetë të qetë «borgjeze». Përtej prakut është bota e re, bota e lirisë, përketej bota e vjetër, bota e robërisë. Nga honi i thellë del një zë i llahuarshëm që i përmënt djalit kalvarin e një jete që i kushtohet luftës për liri. Po realiteti i një shoqërie mbuluar me lot e me gjak, me vuajtje e me robëri, e shtyn përpara, përtej prakut, në luftë për një botë të re.

Dhe djali kapër xen prakun. Drama e madhe e shoqërisë, e brezeve, e përparimit.

E di vallë për m'at' anë se ç' të pret, o more ti,
 Që kërkon të kapërxesh këtë prak? Me bukuri
 I stolisur nga besimi, fort i verdhë në fytyrë,
 Ku qëndrimi i patundur duket posi në pasqyrë,
 Më ngre kokën e përgjigjet ay djalë vetull-zi
 Kundër folësit të fshehur, të tmerruar: un e di.
 E di vallë, gjëmon fundi, se do keç sharje, mundime;
 I përpjekur vis më vis do të mbytesh në mjerime,
 I përbuzur nga të gjithë do të vuash prej urie,
Prapa teje do të qepen të këqijat posi hie
 Dhe në burgje do të kalbesh? do t' të vrasin kushedi
 Lark nga vatr' e dëshëruar! Thotë djali: un e di.
 E di vallë se jo vetëm do lëftohesh prej armiqve,
 Po në mish edhe në shpirt do mundohesh dhe prej
 miqve?
 E di vallë, e di vallë? Një të ngjethur i përshkoi
 Trupin djalit, pastaj tha: që të gjitha do i duroi.
 Nisi honi përsëri: andej kamja, bukuria,
 E një vatre ngushëllimi, e një zëmre dashuria,
 Edhe jeta buzë-qeshur po të ftojnë për gëzime.
 Përse hidhe përtej prakut, përse vete në mundime?
 Kur po hipnin këto fjalë, gryk' e thellë kur gjëmonte,
 Kur pallatit anëmbanë oshëtima bumballonte,
 Para syve të djaloshit u-hap faq' e njerëzisë,
 Dhe me lot e gjak mbuluar u-duk fron' i tiranisë.
 Pa ky skllëvër e patronë, pa si dergjet tërë dheu.

Atéhere me rrëmbim djali prakun kaperxeu,
Edhe humbi nëpër hie... lark u duk duke lëftuar
Me tërbimet e furtunës, gjër sa mbet i copëtuar.

* * *

Po s' e derdhi më kot gjakun luftëtari zëmër-trim:
Mbiu gjaku anembanë, plasi gjaku si kushttrim,
Hapi shtegun e lirisë, la një vrugë, la një vijë
Që po ndjekin turma-turma luftëtarë qindra mijë.
Ja në shpirtin t' im po ndizet flak' e zjarritë poetike,
Ja po ndej në kraharuar unë frymën profetike:
Po gremisen shtete e frone me xhelatë edhe tiranë,
Po përmbysen mizoria, po valon mu në Tiranë
Flak i kuq e madhështor, triumfonjës një flamur,
Që shkëlqen mi njerëzi si një diell, si një nur.
Edhe populli gëzon, pa me bujë e brohori
Atë djalë po kujton që dha jetën për Liri.

V L O R A ¹⁾

Deti gjëmon dhe qielli tym e flakë.
Në mal' e fusha mjegull edhe shi ²⁾.
Po vallë ç'ka, pse qesh kjo Vlora plakë
Si vajz' e re, si nuse me stoli?

1) Është shkruar më 1938, kur u duk shprehit se Italia fashiste që kish kontrollin ekonomik, politik e ushtarak të Shqipërisë, kish vendosur të futej këmb' e krye në vëndin t'onë, e t'a bënte Shqipërinë një kryeurë për zgjerimin e saj në Ballkan, në luftën e përbotëshme që po përgatitej. Në këto rrethana, lufta për çlirimin nacional mernte një karakter të ri: zjarri duhej drejtuar, jo atë kundra regjimit të Zogut, që kish nisur t'u bënte një farë kundërshtimi presjoneve të Mussolinit, po sidomos kundër imperializmit italian. Dihet se një grup politikunësh të grumbulluar rreth organizatës së emigracionit «Bashkimi Kombëtar» (Qazim Koculi, Ali Këlcyra, Rexhep Mitrovica etj.) kishin nisur e po bënin një politikë me drejtim të kundërt. Ata, që gjër atëhere kishin lëftuar, të pakën me fjalë, jo vetëm kundër regjimit të Zogut, po dhe kundër imperializmit italian, tani u bashkuan me grupin e Zares t'udhëhequr nga Mustafa Kruja dhe filluan të thonë se Mussolini do të na shpëtojë nga Zogu e do t'a lërë Shqipërinë të lirë dhe indipendente. Gazeta «Sazani» (shikoni numurin e Nëntorit 1938, artikullin: «Si duhet të punojmë?») e demaskoi këtë manevrë dhe e kualifikoi si trathëti.

Vjersha «Vlora» është shkruar me këtë frymë. U botua për herë të parë në gazetën Sazani më 1938, për herë të dytë më 1941 në gazetën «Liria» në Amerikë, dhe dy herë të tjera nga «Zëri i Popullit»: më 1942 dhe më 1943.

2) Dita e 28 Nëntorit 1912, kur u ngrit për herë të parë flamuri në Vlorë. Fund' i Vjeshtës me shi e njegull, me re e vetëtima, kontraston me Vlorën në gas, të stolisur për një festë kaqë të shënuar.

Ë ishehur nëpër malet madhështore
Ku Shqipëria vetëm kish një fron,¹⁾
Flamur' i Skënderbeut me vitore²⁾
Mi Vlorën sot u-ngrit e po valon.

Nga Çamëria te lum' i Vardarit,
Nga Bregu i Detit gjër te Peshkopia,
Nga Hoti e Gruda te mal' i Oparit
Me ty gëzon, o Vlorë, Shqipëria.

Kudo këndojnë : bekuar qoftë Vlora,
Djep' i flamurit, i luftës për liri.
Kudo thërrasin : bekuar qoftë dora,
Që dolli me flamur në Shqipëri.

Rroftë dit' e flamurit e bekuar !
U-ngjall Atdheu në Vjeshtë të Tretë,
U-përtri Kombi vitin e shënuar :
Një mij' e nëntëqint e dymbëdhjetë.

1) Nënë zgjedhën otomane, vetëm malet kishin ruajtur lirinë e tyre.

2) Vitore në disa vënde të toskërisë quajnë fatin e bardhë, këmbën e mbarë. Vitoria përfytyrohet si një kafsh' e vogël dhe e bukur sikundër është nus' e lalës. Kështu p. sh. në këtë këngë popullore :

Eriu nusja, eriu,
Me vitore pas vetiu.

Një luft' e madhe krisi¹⁾ anembanë,
Me zjarr e flakë botën e mbuloi,
Dhe për të majmur patronë e tiranë
Gjaku bujar i popujve kulloi.

Me armë e topa, me hu dhe me litar
Ushtri' e huaj²⁾ shkeli Shqipërinë ;
Posi kuçedre armiku barbar
Kudo përhapi luftën edhe zinë.

Po prapë u ngrit më këmbë Shqipëria,
Kudo kushtimi zjeu për liri ;³⁾
Me gra e burra dolli Labëria,
Rroku flamurin Vlora përsëri.

Me vete dy fishekë e një kothere,
Gunën mi tela, hidheshin mi Vlorë ;
Rrotull armiq si bleta në koshere
Me topa, mitralozë e me vapore

A ke dëgjuar si kërcet rrufeja ?
A ke dëgjuar si buçet vullkani ?
Ashtu, kur zjente topi e batareja,
Hidhej, gjëmonte ky Selam--Luani⁴⁾

1) Lufta imperialiste 1914-15.

2) Ushtria italiane,

3) Lufta e Vlorës 1920,

4) Selam Musa Salaria, që u vra në kodrat mi Vlorë
pas një sulmi të guximshëm kundër ushtërisë italiane.

U shporr në det nga Vlora e Shqipëria,
Armiku i huaj sy-gjak edhe mizor;
Kudo gjëmuar buja e brohoria,
Kudo valoi flamuri madhështor.

...

Po mbeti në Sazan, ¹⁾ te gryk' e detit,
Kuçedr' e Romës, veshur në çelnik;
Dhe këmbë-kryq pastaj mi fron të mbretit
U-shtrua në Tiranë ²⁾ ky armik.

Me turp e gjak Atdheu po mbulohet,
Po ripet e po shtypet Shqipëria.
Më thoni ju vëllezër: a durohet
Flamuri që të shkelet dhe liria?

O male e fusha, rrotull e vërdallë,
Kudo filloni luftën për liri.
Rroke flamurin, prapë dil në ballë,
Vlor' o moj Vlorë, sulu përsëri.

1) Italia, kur u hoq me 1920, nuk e lëshoi nisin' e Sazanit.

2) Me traktatet e 1926 dhe 1927 në mes të Shqipërisë dhe Italisë vendi i ynë hyri thellë nënë kontrollin e imperializmit Italiane. Në realitet Shqipëria bëhet më tepër se një gjysmë koloni italiane. Kjo tregon pse që e pamundur më 1939 një rezistencë efektive, kur Italia fashiste hyri me forcë në Shqipëri.

BILBIL ENJTË ¹⁾

Natë e madhe e Shënëndreut,
Si kallkani kish pllakosur
Mi të mjerën Shqipëri ;
Dhe, si Shënizat perënduan,
Sillte dita, që afrohej
Me mandata, helm e zi.
Flë Janina. Po me llamba
Në sarajet e valiut ²⁾
Rinë zgjuar e po flasin ;
Dhe përtej në ato budrume,
Te Kalaja ³⁾ përmi gjolin,
Armë e çizme po kërcasin.

1) Bilbilenjtë kanë qënë nga Kurveleshi. Gjithë meshkujt e këtij fisi kishin dalë maleve, siç dilnin në kohën e Turqisë shumë fshatarë : për nonjë hall. Të trathëtuat nga Xhelil Voshtina u zunë nga xhandarët dhe u shpunë lidhur në Janinë. Kur i prunë të një rrap afër Janinës, që t' i varnin, që të trembëdhjetë prapsnë xhelatin dhe u varën me dorë të tyre. Rrapi quhet edhe sot e kësaj dite «Rrapi i Bilbilenjëve».

Populli, ky poet i math anonim, u ngriti një këngë të bukur.

Bilbilenjtë trembëdhjetë,
Vanë në ditarë vetë
Lonet pac, Xhelil Voshtina,
Vrave trembëdhjetë trima.

2) Kështu quheshin guvernatorët e Turqisë.

3) Në kala ishin bodrumet ku mbareshin të burgosurit.

Kë po marrin që me natë
Sot xhandarët e sulltanit?
Ç' ka që del bimbashi ¹⁾ vetë?
Obobo! Shpien të varin,
Lidhur këmbë e lidhur duar,
Trembëdhjetë Bilbilenjtë.

Një nga një hiet e natës
Hipin, çduken. Fryn nga malet
Mi Kala er' e mëngjezit.
Po dëgjohet tek e tuk,
Gjithë mall e dhëmshuri,
Këng' e dredhur e këndezit.

U-kujtohon nën' e motra,
Një shtëpi, një zjarr në vatër,
Dhitë e dhëntë që kullonin;
U-kujtohen çuka e shpella,
Trembëdhjetë si një mijë,
Me koshadhet kur lëftonin.

* * *

Përkëtej Janinës ngrihet
Degë-math e rrënjë-trashë
Rrap i vjetër mi xhade.
Këtë rrap, tregojnë pleqtë,

1) Bimbash ose bimbash (shqip) quhej në ushtërinë Turke një komandant mi njëmijë veta.

Vit për vit e djek rrufeja,
Në dimër, në Shënëndre.

Trembëdhjetë Bilbilenjtë
Te ky rrap i shpu bimbashi,
Mi të gjithë kumandar,
Dhe me vete kish fermanin, ¹⁾
Një bylyk ²⁾ me bylykbashë,
Katër barrë me litar.

Si këndon atje fermanin,
Urdhëron halldup' i Konjës: ³⁾
Ngreu, Bilbil, të heth litarë.
Dale, bej, të krihem pakë,
Dale, bej, të dreth mustaqet,
Dale, bej, të ndes cingarë;

Se nuk jam çanak me dhallë,
Po jam Bilbili me pallë . . .

Një nga një te rrap' i vjetër,
Një mëngjes të Shënëndreut,
Bilbilenjtë trembëdhjetë
Vanë në litarë vetë.

1) Dekretin.

2) Bylyku ishte një njësi e vogël ushtarake.

3) Halldup i quenin përpara turqit me të sharë.

KËNGA E PARTIZANIT 1)

Për popull maleve kam dalë,
Lirisë jetën ja kam falë:
Kokën më torbë, ballin përpjetë
Sytë rrufë, këmbët shigjetë,
Jam partizan — Jam partizan.

Armët kërcasin,
Këngët buçasin,
Dridhen fashistë dhe tiranë,
Kur shkojnë trimat partizanë.

Kushtrimi fushave po zbret,
Gjëmon kudo në çdo qytet:
Ngrihet më këmbë Shqipëria,
Lëkundet zgjedha, robëria.
Lavdi dëshmorit — Vdekje mizorit.

Armët kërcasin,
Këngët buçasin,

1) Është shkruar në Vjeshtën e Parë 1943

Përpjetë grushtet anembanë,
Kur shkojnë trimat partizanë.

Kudo përhapet me guxim,
Shkëlqen si diell flamuri im:
Flamur' i math i vegjëlisë,
Flamur' i bukur i lirisë.
Me gjak i lyer — Po i pathyer.

Armët kërcasin,
Këngët buçasin,
Dridhen gjakpirës e tiranë
Kur shkojnë trimat partizanë.

Jam partizan me yll në ballë,
Për zot, o popull, të kam dalë.
Urrej fashistin pa kufi,
Në Qinë qoftë a në Greqi.
Një bot' e re — Ngjallet mi dhe.

Armët kërcasin,
Këngët buçasin,
Shtrengohen popujt anembanë,
Kur shkojnë trimat partizanë.

SHANGAJ 1)

Shangaj, tym e barut,
Flamur edhe kustrim,
Rebel ti je vigan ;
Edhe buçet e shfryn
Me kraharor milionësh,
O grykë -- oqean.

Shangaj ti je liria,
Ti je revolucioni,

1) Shangaj qytet i math industrial në Qinë, skele me rëndesi t madhe në Pacifik. I njohur për lëvizjen punëtore, simbolizon këtu forcën dhe vrullin e revolucionit qines. Pas luftes revolucionare 1925-27, që mbaroi në shkatërrimin re-
akcionit të përkrahur prej imperializmës japoneze, fronti per bashkët revolucionar u ndo në dy kampe: me një anë «nacio-
nalistët» e Qinës me Çan-Kai-Shek-un në krye; me anën tje-
tër komunistët, që organizuan, në vendet e pushtuara prej tyre, Sovietët. Lufta në mes të këtyre dy kampeve zgjati gjër më 1935, kur Japonia që kish pushtuar Mançurinë zuri të hyjë thellë e më thellë në Qinë dhe partia e Kuomintangut, udhëhequr prej gjeneralit Çan-Kai-Shek u hoth nga politika e kompromisit kundrejt imperializmit japones në luftë të hapët. Atëhere gjithë fuqitë nacionalë përveç reacionarëve pro-japonezë u bashkuan në një front të përbashkët kombëtar për çlirimin e Qinës. Kjo luftë vazhdon edhe sot. Komunistët qinezë lozin një rol të dorës se parë në kete luftë.

Që zjen edhe pëllcet,
Dhe botën e sundimit
Përmbys posi vullkani,
Shkallmon posi tërmet.

Kur ti rremben flamurin,
Shangaj, e shkon përpara
Në luftë për liri,
Lëkundet anembanë
Azi e skllavëruar
Pa funt e pa kufi.

Gjëmon Hubej, Hunani,¹⁾
Kantoni²⁾ me bajrak,
Kalkuta dhe Bombej.³⁾
Kuli⁴⁾ dhe proletarësh
Gullçime prej vigani
Përtej e përkëtej.

1) Hubej dhe Hunani janë dy krahina të mbëdha të Qines, ku në ato kohë ka qënë e fortë levizja revolucionare.

2) Kantoni ka qënë qendra e revolucionit Qines me 1925-27. Më 1928 në Kanton u bë një kryengritje e armatosur që vendosi Komunen e Kantonit. Komuna nuk zgjati shumë kohë dhe u shtyp nga reaksioni.

3) Greva të mbëdha me karakter politik kishin plasur në këtë kohë në shumë qendra të mbëdha të Indisë dhe sidomos në Kalkutë e Bombej.

4) Kuli quhen në Qinë jo punëtorët e fabrikave, po gjithë populli i varfër i qyteteve, që ndodhet në një shkallë varfërie të pashembëll në Perëndim.

Sa herë ti lëftove,
Sa herë re përdhe,
Shangaj, qytet-luan.
Po forca jote shtohet,
Po zjarri po zgjerohet :
Soviete në Hunan,

Soviete në Hubej,
Soviete Guandunit,
U-ngrit katundaria ;
Kërcet në Indoqinë, ¹⁾
Kërcet nga Peshavari, ²⁾
Po ngrihet tër' Azia.

Dhe shokët e Weding-ut ³⁾
Parizit, Detroitit
Vërsulen me furi,
Kudo ushtria e madhe,
Kuli dhe proletarë,
Po ngrihet përsëri. ⁴⁾

1) Në këtë kohë kanë nëndhur kryengritje të forta të anamitëve kundër imperializmit frëngë.

2) Peshavari, qytet në Hindit, është i njohur për kryengritjet kundër perandorisë britanike.

3) Mëhallë punëtore e Berlinit, që në këtë kohë ishte në ballë të lëvizjes revolucionare.

4) Kur është shkruar kjo vjershë, më 1929, në lidhje me krizën ekonomike të përbotëshme, kishte nisur në gjithë botën kundërciensiva e proletariatit dhe e popujve koloniale kundër imperializmit.

Me cylvat e fabrikës, —
Trumbeta të kushtrimit, —
Gjëmo, Shangaj, gjëmo;
Si një çekan — kollos,
O proletar' i Qinë,
Godit edhe rrëzo.

INTERNACIONALIA 1)

Ngreuni ju, o të mallkuar, 2)
Ju t' urët, skllëvër anembanë.
Na buçet gjaku i turbulluar :
S' duam patronë dhe tiranë.
Botën mizore t' a shkallmojmë
Që nga themeli, dhe pastaj
Për veten t'onë të ndërtojmë
Botën e re, në vënt të saj.

Eshtë lufta finale,
Vendimtare mi dhe.
Internacionale
Do jetë bot' e re.

Nga Zoti, mbreti s' duam shpëtimin,
As nga heronjtë kordhëtarë ;
Me duart t' ona ne çlirim
Do t' a fitojmë, o proletarë.

1) Është kthyer shqip më 1927. Ka hyrë në Shqipëri më 1931

2) Të damkësuar me mallkim, të dënuar me robëri nga shoqëria e sotmë.

N' origjinalin, që është shkruar frëngjisht, thuhet kështu :
Debout, les damnés de la terre . . .

Nga zgjedha ju që të shpëtoni
E Kapitalit qën — barbar,
Çekanin ngrini dhe qëlloni
Sa është hekuri në zjarr.

Eshtë lufta finale,
Vendimtare mi dhe.
Internacionale
Do jetë bot' e re.

Nërkombëtare, shokë, jemi
Ushtëria e madhe e punës ne,
Ne vetëm botën do t'a kemi —
Për parazit s' ka vënt mi dhe.
Dhe kur rrufeja do të bjerë
Mi çdo gjakpirës dhe xhelat,
Pa rreshtur dielli do të shtjerë
Mi neve dritën që nga lart.

Eshtë lufta finale,
Vendimtare mi dhe.
Internacionale
Do jetë bot' e re.

PUNËTORËT E AVLËMËNDIT 1)

Në sytë e zgurdulluar s' kanë lot,
Po dhëmbët i kërcasin me furi :
Qefinin t'ënt ne ëndim këtu sot,
Me tri mallkime thurur, Gjermani.
Trike-trak, trike-trak.

Mallkuar qoftë Zoti! ne ju falmë
Në zi e në thëllime pa pushuar ;
Shpresuam edhe pritmë e prapë psallmë,
Po tallje e qesëndi na ka dhuruar.
Trike-trak, trike-trak.

Mallkuar qoftë mbreti! shpirt-mizori, —
Mbret kusarësh, bejlerësh, mbret barbar:
Na piu gjakun, lëkurën na nxori
Dhe sot na vë në plump e në litar.
Trike-trak, trike-trak.

1) Kthyer shqip nga një poezi e poetit të math gjerman, Heinrich Heine. Ky e shkroi me rastin e një greve të madhe të puntorëve tekstilë gjermanë nga mez' i shekullit që shkoi. Ka qënë kjo një nga grevat e para që ka bërë proletariati. Ky përkthim u-botua më 1928 në gazetën «Liria Kom-bëtare».

Mallkuar qoftë atdheu, ku sundon
Luksi pa frë dhe varfëria pranë,
Ku asnjë shpirt i bukur s' lulëzon,
Ku skllavëria shtrihet anëmbanë.

Trike-trak, trike-trak.

Hidhet përpjetë boshti me furi,
Ne dit' e natë endim pa pushuar,
Qefinin t' ënt po endim, Gjermani,
Me tri mallkime rreth e qark punuar.

Trike-trak, trike-trak.

LASGUSH POGRADECI¹⁾

Të blenë me para, o zok liqeri,
Të futnë në kulvi që të këndosh
Pas avazit që do një mbret²⁾ bejlerësh,
Pas avazit që do kuçedr' e huaj:
Kuçedra Kapital me kthetra shumë.³⁾

Dhe ti tani do bëhesh plaçkë tregu,
Dhe reklame të ndritëshme kudo
Për tyj do dalin. Shko, Lasgush, vërtitu
Në botën e djallosur të parasë.
Shiti ndjenjat e njoma⁴⁾, shit aromën
E shpirtit delikat, poet i ~~mjerë~~.

1) Kjo vjershë është shkruar më 1928, kur Lasgush Pogradeci u kthye në Shqipëri dhe u shpall poet kombëtar. Lasgushi, që gjër atëhere kish qënë një poet i ri me talent, me zëmër delikate, që donte dhe këndonte natyrën, hyri në peligun oportunist të intelektualëve të asaj kohe dhe u bë poet dalikauk. Ç' poet kish qënë Lasgush Pogradeci, ç' farë poeti po bëhej dhe si duhet të jetë poeti, ja thelbi i kësaj vjershe.

2) Zogu, kryetar i koalicionit të bejlerëve në Shqipëri.

3) Kapitali italian që po hithte thell' e më thellë kthetrat e tij në vëndin t' onë.

4) Në botën kapitaliste dalin në trek jo vetëm vlerat materiale, po dhe ato spirituale: poezia dhe erti bëhen dhe ato plaçkë tregu.

Zëmra jote do mpihet nër obore,
Do fishket afër frymës së tiranit,
Do bëhet si një kurvë lajka-madhe:
Ajo zëmër që duhej si vullkan
Zjarr e flakë të shfrynte për liri.

Dhe sytë që n' agime kanë lozur
Me ngjyra dhe me dritë të çudicme,
Do të veshen nga luksi dhe nga veset:
Ata sy, që veç duhej të shikonin
Si po shtypet e po rripet një popull
Nga gjakpirës, nga xhelatë e tiranë.

Dhe veshët që dëgjuan harmonira,
Muzikën e mëngjezit nër liqere,
Me lëvdata, me lajka do të myken :
Ata veshë që duhej të dëgjonin
Si zjen lufta dhe si dalin kushtime.

Dhe ato duar që preknë zambakun,
Që fërkuan një leshverdhë nër pyje,
Do të prekin vetëm duar xhelati,
Do të prekin vetëm kartë e flori:
Ato duar që duhej të rrëmbenin
Vetëm pushkë dhe flamur për liri.

A N Ç A R I 1)

Atje ku fushat janë shkretëtirë,
Atje ku tokën vapa përvëlton,
Si karakoll ²⁾ i tmershëm rri ançari:
I vetëm ky në botë lulëzon.

Stepet e përvëluara e pollën
Një ditë zëmërimi plot me gjak,
Dhe degët e zhuritura, të thara
Dhe rrënjët ja vaditnë me farmak.

Pikon farmaku tej-për-tej lëvezhgës;
Ky shkrin në diell ditën e bekuar,
Dhe mbrëmanet pastaj ky ngrin e bëhet
Mu si një dyll' i trashë, i kulluar.

Nuk fluturon as zogu tek ançari,
As tigri nukë vete. Me furi

1) Një nga vjershat më të bukura të poetit të math rus, Aleksandër Pushkin. U botua shqip më 1937 në gazetën «Populli».

Ançari është një dru që rritet vetëm në Arqipelagun Malez dhe dylli i tij është një farmak shumë i fuqishëm.

2) Post.

Mi drun' e vdekjes hidhet vetëm era,
Dhe tutje shkon me vdekjen mu në gji.

Dhe kur e arratisur nonjë re
Të përgjumëshmen gjethe ja vadit,
Kullon nga degët shiu i farmakosur,
Edhe mi rërën derdhet që zhurit.

Po i dha urdhër njeriu njeriut
Dhe e dërgoi tek ançari i helmuar;
U ngrit me natë skllavi edhe vate,
Dhe shpejt u-kthye me farmak në duar.

Pruri yllin e vdekjes dhe një degë
Plot me gjethe të fishkura, edhe
Nëpër faqet dhe mi ballin e zbetë
I kullonte djers' e ftohtë rreke.

Pruri helmin, dhe ju prenë fuqitë;
Gjer e gjatë në kasollet u-shtri,
Pa dha shpirtin skllav' i mjerë mi kashtë
Mu në këmbët e të zot zëmër-zi.

Sulltanë e mbretër me atë farmak
Ngjyen pastaj shigjetat, dhe me to
Përhapnë zi e vdekje nëpër fqinjët —
Fërtej kufive t' huaja, kudo.

F S H A T I T T' I M ¹⁾

O fshati im i mbyllur, i harruar,
Me male rreth e rrotull, ku rri shkaba
Edhe hap krahët qiellit madhështor,
Un tyj të falem. Shpella dhe gremina,
Kroje e burime ke si Porodani,
Dhe si Dëstila m' ara e stolisur,
Që e vadit rrungaj' e mesme, e bukur,
E cila rrukulliset tatëpjetë
Me forcë të pamatur nga Goliku. ²⁾
Ke mi Sjadunë e thatë me gorrica
Shkëmbënj të lartë shumë, ku larashi
Sillet përçark me madhëri mizore. ³⁾
Ke lisa të mbëdhenj e plot me forcë,
Ke burra trima e vajza bukuroshe,
Ke dhën e dhi me zile e me këmborë.

1) Është shkruar më 1920. U botua në rivistën «Shpresa e Atdheut» që nxirte në Romë asaj kohe «Shoqëria e Studentëve Shqiptarë në Itali».

2) Mal' i Golikut.

3) Kupëtimi i parë i fjalës «mizore» është: qe sundon. Këtu është përdorur me këtë kupëtim. Shiko këngën popullore:

O moj Shkodër, moj mizore,
Pak u duke e shum na dole:
Po lufton me tre tabore; etj.

. . . .
Kur të kujtoj, mejtimet më burojnë
Fisnike dhe të larta: fluturon
E ndezur fantazia aty nër male:
Shoh brinj' e rrëza me kullotë e lule,
Shoh pyje e lisa, dhe nëpër burime
Zëra që lahen . . . fshehur nëpër ferra
Dreth këngë të përmallshme dashurie
Bilbil' i shkretë . . . Vajzat fshatarake
Shtrihen mi bar e ndjellin dashuri.

. . . .
Kur dita ngryset edhe bie kambana,
Bërtasin lopët, shqerrat blegërijnë,
Dëgjoj këmbor' e zile nga Zasteni,

. . . .
Ja po del hëna dhe po zbardhen brigjet.
Po shoh tani në lëmin e Sheshtojës
Vajza me djem që shijnë e hedhin valle.
Shkoi meç' i natës . . . Shënizat po largohen
Dhe kafshë e njerëzi mi dhe pushojnë.

. . . .
Ja diell' i bukur mi Golikn' e lartë
Ngre të shkëlqyer kokën madhështore,
Ja edhe lulja që po qan me lot
Ngrohët e ngjallet nga ajo frym' e shënjtë,
Ja edhe lis' i math i Shëndëlliut,
Me gjeth' e degë që përpiqen n' erë.
Duket sikur po shkunt nga trup' i fortë

Gjumën e natës Zoqtë nëpër ferra
Ose mi dega bukur e kulluar
Në freshkësinë e pyllit po ja thonë.

. . .

I ngrysur në fytyrë a buzëqeshur,
Ti kurdoher' i bukur je për mua:
Aty, kur dimri vjen e bubullima
Kodër më kodër nis edhe kërcet,
Bariu i malit, futur nëpër shpella,
Gunën më kokë, fyellin më duar,
Rri edhe ja mban këngës së rrebeshit.

. . .

U largova prej teje dhe pandeha
Se përtej detit, lark nëpër qytete
Fshihej një botë veshur me magji.
Njoha fise dhe popuj, e mësova
Se dituria qënka hidhërim.
Lark, o qytet! Rrëmuja dhe poterja
Më lodhin mëndjen, më trazojnë shpirtin,
Më turbullojnë ndjenja dhe dëshira.
Lark, nga qyteti! Pritmë o fshat'i bardhë —
Aty po vij, aty ku qesh natyra,
Ku zëmra gjën pushim e qetësi.

SHTËRGATA ¹⁾

Dëgjoni, dëgjoni,
Nga deti shikoni
Si shfryn e tërbohët,
Si vjen e zgjerohët
Në qiell, në dhe —
Kaluar mi re,
Të zeza si nata,
Shtërgata.

Nga zalli pò ngrihet
Si mal, e përzihet
Me breshër, me shi,
Një pluhur i zi.
Dhe rrotull në det,
Në fshat e qytet
Përhapet rrëmuja
Dhe kuja. ²⁾

1) Është shkruar më 1940. U botua më 1942 në gazetën
«Liria» në Amerikë.

2) Ulërima.

Ki sh pyet për djalin,
Për lopën a kalin ;
Një plakë qyqare
Kerkon një manare ;
Një nuse shikon,
Mos duket përgjon
Në detin e largë,
Një barkë.

Po qielli dhe deti,
Të dy si tërmeti.
Dhe shpesët i ndjek,
Dhe barkat përpjek,
Dhe pemët rëzon,
Dhe arat shkretton,
Dhe bie mandata —
Shtërgata.

MBRETI I TULËS

(W. GOETHE)

Na ish një mbret në Tule,
I besës gjër në varr.
I dha, tek vdiste, mikja
Një kupë derdhur ar.

Si atë s' duaj gjë tjetër,
Më çdo gosti e shpinte,
E syve lot i shkonin
Sa herë me të pinte.

Dhe, kur ju afua vdekjes,
Të birin thiri e pa,
Qytete e ç' kish ja fali,
Po kupën nuk ja la.

Mi det, në një kështjellë
U shtrua me dolli,
E mblodhi rreth e rrotull
Kalorësit e tij.

Atje të jetës afshin
Ë fundit piu plaku.
Pastaj bekriu në vala
Të shënjtën kupë e flaku.

E pa që ra, që kridhej,
Që shkoi në funt atë.
I u-errën syt' e ballit,
E s' piu kurrë më.

PAS TËRMETIT 1)



S' duken më ar' e luadhe,
Po' balt' e vithisur,
Dhe kasoll' e katundarit
Shuar e gremisur.

Po në mes të asaj greminë
Ujë të rjeth e shkon,
Edhe dielli pa pushuar
Rrëmbat i lëshon.

Poshtë e thellë dheu i lashtë
Vlagë ka në gji
Edhe zëmra e njeriut
Zjarr e trimëri.

Do të ngjallet propë jeta
Duke lulëzuar ;
Anëmbanë do përhapet
Duke gurgulluar.

1) Shkruar në burk, më Qershor 1940

Përsëri do të shkëlqejnë

Ara dhe bostane.

Do ja thotë këngës prapë

Zëmra kapedane.

Do të rrjedhë jeta-plakë

Pa funt, pa kufi ;

Dhe do ketë si kurorë --

Punë e dashuri.

P È R T E J R E V E ¹⁾

Përtej reve mëndja ime,
Si një zok i arratisur,
Sillet *sonde, s' di* përse.

Sa e madhe heshtja rrotuli,
Sa e thellë errësira,
Sa mërzi që ka mi dhe.

Si kandilë ndizen qiellit
Xhixhëllima miriade —
Jet' e madhe pa kufi.

Ato shtigje mëndja ime,
Shpirti im i arratisur,
Po kërkojnë kushedi.

1) Shkruar më 1942.

FIRST RIVER

THE FIRST RIVER
OF THE STATE OF
NEW YORK

AS APPEARED IN
THE YEAR 1800

BY
JAMES M. SMITH

NEW YORK:
PRINTED BY
J. M. SMITH

L E N D A

	<i>Faqe</i>
<i>Parathënje nga B. Londo</i>	9
Poeti rebel	15
Furtunës	19
Si e dua Shqipërinë	20
Kënga e plakut	23
Klithma e Dragobisë	26
Praku	36
Vlora	39
Bilbilentë	43
Kënga e Partizanit	46
Shangaj	48
Internacionalia	52
Punëtorët e Avlëmëndit	54
Lasgush Pogradecit	56
Ançari	58
Fshatit t'im	60
Shtërgata	63
Mbreti i Tulës	65
Pas tërmetit	67
Përtej reve	69